



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosova



Komuna e Istogut
Opstine Istok / Municipality of Istog

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi / Direkcija za Poljoprivredu, Sumarstvo i
Vodoprivredu / Departament of Agriculture, Forestry and Hydro-economy

09. Nr. 315 / 2022

Datë. 06.12.2022

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Hidroekonomisë, bazuar në vendimin e Kryetarit të
Komunës Nr. 01-101/022 të datës 06.12. 2022 shpallë:

THIRRJE PER APLIKIM

Për mbështetjen e fermerëve në ngritjen e pemishteve drufrutore (kumbulla qershi)

Ftohen të gjithë fermerët e interesuar të komunës së Istogut që të aplikojnë për mbështetje në
ngritjen e pemishteve të reja kumbullës dhe qershisë,

Mënyra e përkrahjes së fermerëve në projekt.

- Planifikohet furnizimi i fermerëve, në pako me material fidanor, pajisje të sistemit të ujitjes pikë-pikë, gërrshërë elektrike për krasitje dhe trajnime për procedurat e ngritjes së pemishteve dhe masat e përkujdesit në pemishte.
- Do përkrahen fermerët, për sipërfaqen e pemishteve, 0.30 – 0.90 ha ;
- Furnizimi me fidane dhe pajisje për fermerët do bëhet nga ana e Drejtorisë së Bujqësisë – Komuna e Istogut
- Fermerët përfitues janë të obliguar që të përcjellin të gjitha trajnimet e nevojshme për kultivimin e pemëve
- Shpërndarja e materialit fidanor dhe pajisjeve do të bëhet pasi të përzgjedhen fermerët të cilët i plotësojnë kriteret e parapara
- Te jetë i gatshëm të financoi 20 % të vlerës së projektit

Kriteret e përgjithshme që duhet ti plotësojnë fermerët/aplikuesit

- Të jenë banorë të komunës së Istogut
- Ti ketë të shlyera obligimet ndaj komunës
- Të posedoi tokë bujqësore në pronësi apo të marrur me qera në territorin e Komunës së Istogut
- Përparësi do të kenë fermerët aplikues me sipërfaqe më të madhe të tokës së planifikuar për kultivimin e këtyre kulturave
- Përparësi kanë fermerët që nuk kanë qenë përfitues nga drejtoria e bujqësisë në tri vitet e fundit
- Përparësi do kenë familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës

- Në kushte të barabarta përparësi do të ketë kush aplikon i pari

Dokumentacioni i nevojshëm

- Letërnjoftimi
- Vërtetimi i tatimit në pronë
- Fleta poseduese dhe kopja e planit të parcelës,
- Deklaratë nën betim për të drejtën e shfrytëzimit të tokës (merret në drejtorin e bujqësisë, zyra nr. 200)

Përiudha e aplikimit:

Aplikimi zgjatë 4 ditë kalendarike dhe fillon që nga dita e shpalljes publike, nga data 06.12.2022 dhe përfundon më datë 09.12.2022 në ora 16.00

Mënyra e aplikimit:

Aplikimi bëhet në Qendrën për Shërbim me Qytetarë Nr: 100

Aplikacionet që nuk e kanë dokumentacionin e kërkuar sipas thirrjes nuk do të shqyrtohen.

Informacione shtesë mund të merren pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Hidroekonomisë në zyrën nr. 200